| **Buletini Nr. 27 / 2026, 27-01-2026** | **Parashikimi** nga 27-01-2026, ora 12:00 deri 28-01-2026, ora 23:59. |
|---|---|

## PARASHIKIMI METEO

----------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e martë, dt. 27) priten reshje të dobëta. Nesër (e mërkurë, dt. 28) në qarqet Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër priten reshje mesatare deri lokalisht intensive, ndërsa në qarqet Kukës, Dibër, Lezhë dhe Durrës priten reshje mesatare. Në Tiranë, Elbasan dhe Korçë reshjet priten të dobëta deri lokalisht mesatare. Reshjet priten të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në Veri, Lindje dhe Juglindje në lartësitë mbi 900 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si rënie gurësh e inertesh dhe vërshime të ujit në zonat urbane të lokalizuara, në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastër.

### TEMPERATURA

Nesër (e mërkurë, dt. 28) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 7 / 14 °C
në vendet e ulëta: 3 / 13 °C
në vendet malore: 0 / 9 °C

### ERA

Sot pasdite (e martë, dt. 27) dhe nesër (e mërkurë, dt. 28) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet dhe në zonat malore deri shumë e fortë

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S'KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LART** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **DIBËR** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **LEZHË** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **DURRËS** | S'KA RREZIK | mesatare | | | | | |
| **TIRANË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **ELBASAN** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **FIER** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **BERAT** | S'KA RREZIK | të dobëta | | | | | |
| **KORÇË** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare | | | | |
| **VLORË** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |
| **GJIROKASTËR** | S'KA RREZIK | mesatare | intensive | | | | |

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** *(Bulletin on Natural Hazards)*

***Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore***

*Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al*

| **Buletini Nr. 27 / 2026, 27-01-2026** | **Parashikimi** nga 27-01-2026, ora 12:00 deri 28-01-2026, ora 23:59. |
|---|---|

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 27–28.***

## *SIMBOLE*

| | |
|---|---|
| | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
| | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
| | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
| | Rrëshqitje toke |